

RAPORT PËR MBLEDHJEN E KOMISIONIT SHQIPTARO-MALAZEZ PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ME INTERES TË PËRBASHKËT

Në zbatim të VKM-së nr.745, datë 19.12.2018, “Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për marrëdhëniet e ndërsjellta në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare” dhe VKM-së nr.113, datë 6.3.2019, “Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët”, në datën 15.04.2021, online, u zhvillua mbledhja e Komisionit Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët.

Në këtë takim u diskutuan këto pika:

1. Projekti Unesco “Projektimi dhe testimi i rrjetit për monitorimin e ujërave nëntokësore në Shqipëri dhe Mal të Zi” në kuadër të GEF mbështetur nga projekti “Mundësimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe integritetit të Burimeve Ujore”
Perspektiva e bashkëpunimit, krijimit të institucioneve dhe rregulloreve përkatëse.
2. Zbatimi i projektit “Përshtatja klimatike, menaxhimi i integruar i riskut nga përmbytjet në basenin ndërkufitar të Lumit Drin”.
3. Diskutim rreth aktiviteteve në lumin Grnçar.
4. Diskutim rreth krijimit të grupeve të punës për monitorimin ndërkufitar dhe hapave që duhen marrë.
5. Diskutim rreth aktiviteteve për një menaxhim më të mirë të pellgut të liqenit të Shkodrës me lumin Buna.

Lidhur me pikën e parë, pala shqiptare informon lidhur me instalimin në anën shqiptare të dy puseve në Velipojë dhe Musham duke shpjeguar se ky informacion është në testim dhe duke u menaxhuar nga institucionet përgjegjëse që janë Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Gjithashtu pala shqiptare i kërkoi palës malazeze ta informonte lidhur me ecurinë e këtij projekti në Mal të Zi. Pala malazeze shprehu gatishmërinë për dhënien e informacionit. Për këtë pikë palët ndanë qëndrim të njëjtë për shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit të ndërsjellët.

Lidhur me pikën e dytë, pala shqiptare sqaron se informacioni i kërkuar nga pala malazeze do t’i përcillet palës malazeze.

Në vijim, pala shqiptare i kërkoi palës malazeze ta informonte lidhur me fazën e zbatimit të projektit. Pala malazeze sqaroi se është duke përgatitur të dhënat teknike. Për këtë pikë palët ranë dakord për ngritjen e grupeve teknike për të dhënat konkrete të projektit.

Përfaqësuesit e palës shqiptare, nga MBZHR dhe KESH sqaruan palën malazeze se lidhur me argjinaturat e Lumit Buna në krahun e majtë dhe në segmentin e argjinaturës Reç Pulaj është bërë vetëm rehabilitimi i tyre dhe nuk janë ndërtuar argjinatura mbi kuotat ekzistuese. Lidhur me çështjen e kuotave sugjeron rishikimin e kuotave duke pasur një referencë të dakordësuar.

Në vijim, palët bien dakord për t'i përcjellë palës malazeze informacionin e kërkuar dhe organizimin e një takimi të përbashkët për diskutimin e të dhënave teknike të projektit.

Lidhur me pikën e tretë, pala shqiptare sqaron se është bërë verifikim në terren dhe projekti nga FSHZH lidhet me ndërtimin e rrugës duke pasur qëllim mbrojtjen e rrugës dhe mbrojtjen e pikës kufitare. Pala malazeze nga ana tjetër sqaron se këto aktivitete janë përmendur dhe në takimin e parë duke kërkuar nga pala shqiptare informacion nëse do të ketë ndërtime të tjera në të ardhmen.

Pala shqiptare sqaron se pas takimit të parë është bërë verifikimi në terren dhe u konstatua se ndërhyrja lidhet me mbrojtjen e rrugës dhe nuk ka ndikim në shtratin e lumit duke shprehur gatishmërinë për ta parë në nivel teknik nëse kërkohet.

Pala shqiptare i kërkoi palës malazeze ta informonte lidhur me aktivitetet në lumin Grnçar. Gjithashtu, iu paraqit shqetësimi lidhur me shfrytëzimin e inerteve dhe ndikimin që ato kanë në devijimin e shtratit të lumit Grnçar. Pala malazeze nga ana tjetër sqaron se janë bërë heqje e materialeve që i sillte Lumi Grnçar dhe nuk ka pasur ndërhyrje. Gjithashtu palët ndanë qëndrim të njëjtë për shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë.

Lidhur me pikën e katërt, pala shqiptare sqaron se institucionet përkatëse po caktojnë përfaqësuesit për ngritjen e grupit teknik. Gjithashtu pala shqiptare kërkoi informacion nga pala malazeze lidhur me këtë çështje në mënyrë që të diskutohet për hapat që do të ndiqen. Ndërkohë pala malazeze sqaron se kanë caktuar përfaqësuesit e tyre. Palët ranë dakord për organizimin e takimit të përbashkët për të rënë dakord lidhur me hapat e radhës dhe detyrat e grupit teknik.

Në pikën e pestë, pala shqiptare propozon për të dyja vendet aplikimin për projekte të përbashkëta për promovimin e turizmit dhe burimeve ujore.

Pala malazeze shprehu shqetësimin lidhur me kuotat e liqenit të Shkodrës. Përfaqësuesi i palës shqiptare, nga KESH sqaron se kaskada e Drinit ka rol mbrojtës për efektet e përmytjeve dhe nuk është shkarkuar sasi më e madhe uji se kuotat. Në vijim sqaron se duhen parë kapacitetet shkarkuese të lumit Buna. Gjithashtu pala shqiptare sqaron se lidhur me projektin e përbashkët nuk është rënë plotësisht dakord për shkak të mospërputhjes së kuotave në liqenin e Shkodrës. Palët ranë dakord për gjetjen e një modeli të përbashkët lidhur me këtë çështje.

Gjithashtu palët ranë dakord për shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë lidhur me trajtimin e ujërave të zeza në lumin Buna.